



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 18856 Prot.

Lezhë, më 01 . 10 . 2021

**VENDIM**

Nr. 152 Datë 28 . 10 . 2021

**“PËR PËRCAKTIMIN E STRUKTURËS SË BANIMIT PËR SUBJEKTET PËRFITUESE  
NË NDËRTESTAT (PALLATET) TË RINDËRTUARA PAS “TËRMETIT TË 26-  
NËNTORIT” NË LAGJEN “BESËLIDHJA””**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 42, pika 1, shkronjat “b” dhe “d”, nenit 57, nenit 58 të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar dhe Aktit Nr. 09, datë 16.12.2019 “Per përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.115, datë 26.08.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 141, datë 14.10.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

**VENDOSI :**

1. Përcaktimin e strukturës së banimit për subjektet që do të akomodohen në njësitë e reja të banimit në ndërtesat e reja të rindërtuara në Lagjen “Besëlidhja” të shpallur përfitues me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.115, datë 26.08.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë” dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 141, datë 14.10.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5

sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë e pandashme e këtij vendimi me një ndryshim: numri rendor 57 i listës (M. S. Z.) përfiton strukturë banimi 1+1 dhe numri rendor 23 i listës (E. Xh. L.) përfiton strukturë banimi 2+1.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 , të nenit 55 , të ligjit nr . 139/2015 , “ Për vetëqeverisjen vendore ”, të ndryshuar .

**SEKRETARI**

**FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI**

**ERNEST RAKAJ**

